



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**  
***Sesioni vjeshtor***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **30**

Prishtinë, më 20.11.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Salih Salihu, Salih Zyba, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Etem Arifi dhe Danush Ademi.

Mungoi: Srđan Mitrović.

Të ftuar : Fatmir Matoshi, ministër i MMPH-së, Arben Çitaku- sekretar i MMPH-së, Ilir Morina- kryeshef i AMMK-së

Stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 6.11.2018;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017, i ftuar Ministri i MMPH,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Produktet Biocide,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit,
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 nëntor 2018**

**Muharrem Nitaj**-kryetar, konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.11.2018.

### **3. Shqyrtimi i raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017, i ftuar Ministri i MMPH-së**

**Muharrem Nitaj**- kryetar, njoftoi se për të diskutuar për raportin e gjendjes së mjedisit për vitin 2017, i ftuar në mbledhje është Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Z. Fatmir Matoshi dhe para se t'ia jep fjalën e falënderoi për pjesëmarrje.

**Fatmir Matoshi**, ministër i MMPH-së, tha se Raporti i për vitin 2017 i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe raportet e tjera nga institucionet e Kosovës apo ndërkombëtare, tregojnë për gjendje jo të mirë të mjedisit. Mos dhënia prioritet e mjedisit nga institucionet tona me vite, ka bërë që krahas rindërtimit dhe ndërtimit të vendit, mjedisi të shkatërrohet dhe degradohet. Në vazhdim tha se Ministria po angazhohet në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në shumë sektorë, duke përfshirë: furnizimin me ujë të pijshëm, trajtimin e ujërave të zeza, rregullimin e shtretërve të lumenjve, mbrojtjen e burimeve ujore, menaxhimin më efikas të mbeturinave, mbrojtjen e zonave të mbrojtura si dhe plotësimin e kornizës ligjore.

Në vazhdim përmendi disa angazhime konkrete të Ministrisë siq janë : Task forca “ta pastrojmë Kosovën” prej datës 15 shtator ka arritë të grumbullojë shumë mbeturina dhe me pjesëmarrje prej 100 mijë qytetarëve; Konsolidimi i një granti me vlerë 22 milion Euro, që është participim i MMPH-së, GIZ-it, Komisionit Evropian, MAPL-së, Qeverisë zvicerane, që është një grant i performancës për komunat në vitin 2019, komunat do të shpërblehen në bazë të performancës që tregojnë në grumbullim dhe menaxhim të mbeturinave; Në kuadër ta angazhimeve për përmirësimin e mjedisit, me propozimin e MMPH-së dhe të Task Forcës për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, janë marrë këto vendime : nga Ministria e arsimit për ndërprerjen e përdorimit të thëngjillit në shkolla si lëndë djegëse; nga ministri i zhvillimit ekonomik për ndërprerjen e dhënies së thëngjillit për punëtorët e KEK-ut dhe nga Qeveria për ndërprerjen e përdorimit të thëngjillit në institucionet publike. Këtë vendim e ka marrë qeveria para dy jave, ende është herët të dihet se ku po zbatohet dhe sa po zbatohet, disa institucione mund të kenë probleme me kaldajat deri sa të bëjnë ndryshimet.

Ministri Matoshi i falënderoi deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratim të ligjeve në fushën e mjedisit dhe i'a kaloi fjalën kryeshefit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit për ta prezentuar raportin.

**Ilir Morina**, kryeshef i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), tha se hartimi i Raportit është i bazuar në Nenin 25 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe sipas kërkesave ligjore përmban të dhëna për : gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, ndikimet mjedisore në shëndetin, zbatimin e strategjisë së mjedisit, masat e ndërrmarra për mbrojtjen emjedisit, zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit. Raporti gjithashtu shtoi ai, përgatitet edhe sipas kërkesave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit, dhe si i tillë pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës do të publikohet. Në krahasim me raportin paraprak ka pak përmirësime të gjendjes së mjedisit, mirëpo edhe më tutje më shqetësuese është sektori i ndotjes së ajrit, sidomos në sezonën e dimrit, ku fillon të përkeqësohet në shtator deri në prill. Ai shtoi se monitorimin e cilësisë e ajrit e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës në 2 stacione në Prishtinë, 6 stacionet tjera në Mitrovicë, Drenas, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, Gjilan, 3 stacione në zonën e KEK-ut (Dardhishtë, Palaj dhe Obiliq) 1 në Brezovicë dhe 1 stacion mobil. Me ndihmën e Komisionit Evropian kemi arritë që 5 parametra ndotës ti përcjellim online. Gjatë vitit 2017 ka pas tejkalime të vlerave të lejuara të ndotësve në Prishtinë, Gjilan, Obiliq, Drenas. Ndotësit më të mëdhenj llogaritet të jenë Termocentralet, veturat e vjetruara, karburantet jo cilësore dhe thëngjilli. Ndërsa raporti final i burimeve të ndotjes do të dalë në muajin prill dhe jemi duke bashkëpunuar me JICA-Japoneze. Ai përmendi edhe raportin për ujin dhe tha se nuk ka sistem të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe por ka sistem të monitorimit të ujërave tokësore, po ashtu vazhdoi edhe me, tokën, biodiversitetin si dhe ndikimet e mjedisit në shëndetin e popullatës.

**Muharrem Nitaj**, kryetar, tha se nga vizita e Komisionit në Obiliq, KEK dhe Qendrën e automjeteve ndër shqetësimet e shumta ishte edhe dukuria e hapjes ilegale të minierave për thengjill dhe që ky thengjill përfundon në treg, çfarë vepron MMPH në këto raste ?

**Liburn Aliu**, për investimeve kapitale te raporti 9 mujor, tha se 89 projekte që kanë qenë të planifikuara nga MMPH nga të cilat 64 prej tyre nuk kanë fillu fare, ndërsa prej 25 që kanë fillu vetëm 11 prej tyre janë me mbi 50% të realizuara dhe kjo është një problem i madh sepse shume prej tyre kanë qenë të nevojshme. Pastaj për projektin për sistemin e bazës së të dhënave, sistemit të informacionit kadastral, sepse të gjitha projektet e planifikimit hapësinor e kanë të domosdoshme databazën që varet nga Ministria. Disa nga komunat e kanë hartuar këtë databazë, por që nuk janë funksionale dhe të qasshme pasi që varen nga Ministria, çështja e mos investimit në ndërtimin e deponive komunale, sidomos qyteteve të mëdha Prishtinë, Prizren, Pejë. Në fund ai shtroi 2 pyetje: çka është duke bërë ministria për ndalimin e prerjes së pyjeve në parkun nacional të Sharrit në pjesën e Kaçanikut dhe a ka autostrada Prishtinë-Shkup vlerësimin strategjik mjedisor VSM-n ?

**Besa Gaxherri**, shprehu shqetësimin e saj lidhur me ndotjen e lumenjve, deponit ilegale dhe dëmtimet e pyjeve sidomos në parkun kombëtar Bjeshkët e Nemuna, ajo citoi pikën 1 dhe 2 të rezolutës së Kuvendit të shkurtit 2018, *“Mbrojtja e ambientit të shëndrrohet në prioritet shtetëror”*, *“Kërkohet nga Qeveria të rishikohet dhe të plotësohet me masa shtesë Strategjia për mbrojtjen e mjedisit brenda 6 mujorit të parë”* dhe pyeti sa janë realizuar këto dhe përfundoi me pikën e fundit të kësaj rezolute *“Në rast se Qeveria nuk i zbaton masat e propozuara, Kuvendi të fillojë procedurat për ndryshimin e nenit 52 të Kushtetutës në mënyrë që e drejta për ajër dhe ujë të pastër të përfshihet si e drejtë e garantuar e njeriut me Kushtetutë”*.

**Salih Zyba**, tha se sipas Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, raporti duhet të përmbajë ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës dhe masat e ndërmarrë, dhe pyeti se cilat masa janë ndërmarrë, pasi që në raport shihet se ka zero dënime mandatore. Ai shprehu shqetësimin për prerjen e pyjeve dhe nivelin e sigurisë së rojeve, për minierat ilegale të thengjillit, mos ndërtimin e deponisë në Prishtinë dhe në fund kërkoi një raport nga Ministria për ndërtimet e viteve të fundit në Brezovicë si dhe ndërtime Hade dhe Shipitullë.

**Ganimete Musliu**, pyeti a ka kapacitete Ministria për zbatimin udhëzimit administrativ për gjobat mandatore, sa inspektorë qendrorë dhe lokal janë. Shprehu shqetësimin për ndotjen e mjedisit nga përdorimi i qeseve plastike, mungesën e kontejnerëve për mbeturina në të gjitha lagjet e Prishtinës si dhe pyeti a ka ministria një strategji afatgjate dhe të qëndrueshme për zgjidhjen e këtyre problemeve.

**Andin Hoti**, në lidhje me konfiskimin e thengjillit sidomos në ekonomitë familjare tha se shteti nuk ka të drejtë konfiskimin dhe pyeti a ka ndërmarrë ministria fushatë informuese për ndikimin në shëndetin e popullatës të thengjillit dhe për një lloj të peletit që përmendet koheve të fundit i cili hyn nga Serbia dhe ka substanca të rrezikshme dhe cili është bashkëpunimi me doganën dhe Ministrinë e tregtisë në lidhje me këtë, në fund pyeti pse po zbatohen pjesërisht strategjia dhe plani i veprimit për ajrin ?

**Danush Ademi** shprehu interesimin për dallimin në mes të shitjes ilegale dhe legale të thengjillit.

**Salih Salihu** potencoi se Raporti rikonfirmon se gjendja e mjedisit nuk është më e mirë si në ajër, tokë, ujë etj dmth është i njëjtë me atë të vitit të kaluar gjithashtu përsëriten rekomandimet e njejta, ndërsa gjendja në terren nuk ndryshon.

**Ministri Matoshi**, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të deputetëve tha se, për dallim nga qeveritë e mëparshme, mbrojtja e mjedisit është prioritet, kanë filluar projekte e mëdha, për trajtimin e ujërave të zeza, janë nda 1 milion euro për Ligjin e Obiliqit, së bashku me Bankën botërore rritjen e rezervave ujore edhe me 2 akumulime ujore, granti për performancën në menaxhimin e mbeturinave për 5 komunat më të sukseshme, akcioni ta pastrojmë Kosovën, etj.

Për minierat ilegale të thëngjillit tha se kjo është përgjegjësi e KPMM-së dhe inspektorët e MMPH-së me ftesë të KPMM-së do të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë. Ka pas një akcion para disa diteve në bashkëpunim me KPMM dhe policinë e Kosovës për konfiskimin e thëngjillit që shitet në rrugë dhe janë konfiskuar 7 kamionë me thëngjill 2 në komunën e Vushtrrisë, 3 në Skënderaj, 1 në Fushë Kosovë dhe 1 në komunën e Graçanicës.

Ka pasë nevojë për të gjitha kto 89 projekte dhe kanë qenë të buxhetuara. Kjo është marrë me seriozitet dhe gjendja sot është më e mirë, numër i madh i projekteve që nuk kanë mund të realizohen janë bartë te komunat.

**Arben Çitaku**, sekretar i MMPH-së, dhe tha se raporti i shpenzimeve është krijuar në 9 muor ndërsa të dhënat janë deri në muajin korrik dhe tani jemi në 70% të shpenzimit të buxhetit dhe planifikimi deri në fund të viti do të jetë mbi 80%. Arsyeja se janë disa projekte në nivel të ulët, janë projekte shumë vjecare dhe është e pamundur të shpenzohen brenda 1 viti, për shkak të dinamikës së ulët të prokurimit brenda komunave. Projekti i Spakut, është çështje e bashkëpunimit ndërkomunal, mbi 16 komuna janë në proces të hartimit të hartës zonale, vetëm komuna e Fushë Kosovës e ka përgatitë këtë deri më tash. MMPH është në pritje të udhëzimit administrativ, për të pasë qasje komunat në këtë databazë. Ndërsa **Ilir Morina**, kryeshef i AMMK-së, për parkun kombëtar Sharri u përgjigj se është përgatitë një plan menaxhues i cili parshih një staf profesional prej 24 personave dhe 28 roje, e në fakt janë vetëm 11 punëtor dhe 8 roje. Kërkesa jonë përsëritet që 3 vite me radhë për shtimin e numrit të rojeve por Ministria e financave nuk e ka miratu dhe që 2 vite Kaçanikun dhe Shtërpcen e mbajmë me disa punëtorë me kontratë mbi vepër. Në vazhdim tha se është kontraktuar një kompani për sigurimin e 8 pika hyrëse dhe dalëse në Parqe kombëtare, 4 në Bjeshkë të Nemuna kanë fillua punën dhe kanë dhënë rezultatet e para.

**Ministri Matoshi**, vazhdoi për deponitë tha se ka memorandum bashkëpunimi me komunën e Prishtinës dhe Prizrenit, të cilat kanë marrë nga 50 mijë euro. Për mbetjet e rrezikshme të azbestit, është parapa një pilot projekt 12 milion euro donacion nga KE-ja për vitin 2019, por ka vështirësi me kundërshtimin e deponisë nga qytetarët e Harilaqit dhe komuna e Fushë Kosovës. Për ndërtimet në Brezovicë përmendi se inspektorati i Ministri në periudhën janar- tetor ka dërgua 48 fletparaqitje një pjesë e tyre marrin leje edhe në komunë.

Është duke u diskutuar me shoqatën e tregtarëve me pakicë çështja e plastikës dhe qeseve të plastikes. Vetëm “Kosova thëngjilli” ka licencë për shitjen e thëngjillit të përpunuar i cili është legal, ndërkaq për një tip të peletit që importohet nga Serbia tha se është ngritë në task forcën për ajrin dhe është kërkuar nga dogana të merren mostra dhe të bëhen verifikimet.

Vazhdimisht është kërkuar nga Ministria e infrastrukturës për zbatimin e Udhëzimit administrativ për kontrollin e emitimeve të gazrave në ajër gjatë kontrollit teknik të automjeteve dhe kemi shpreh pakënaqësinë me kontrollin e cilësisë së derivateve që hyjnë në Kosovë.

Ka filluar zbatimin e Udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatore, për hedhjen e mbeturinave në vende të palejuara dhe në mungesë të inspektorëve të mjaftueshëm ai tha se do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me inspektorët komunale dhe policinë e Kosovës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Në fund të diskutimeve kryetari **Nitaj**, pasi e falënderoi ministrin Matoshi me bashkëpunëtorët për raportimin, ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se Komisioni me 4 vota për dhe 3 kundër, vendosi që Kuvendit, t’ia paraqet këtë:

### **Rekomandim**

*Të miratohet Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-130 për Produktet Biocide**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin Nr. 06/L-130 për Produktet Biocide dhe shtoi se ai i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Pasi që nuk pati asnjë diskutim, ftoi Komisionin për votim: kryetari konstatoi se komisioni me 6 vota për, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

#### **Rekomandim**

*Të miratohet në parim Projektligji Nr. 06/L-130 për Produktet Biocide.*

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-132 për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin Nr. 06/L-132 për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit dhe shtoi se ai i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Pasi që nuk pati asnjë diskutim, ftoi Komisionin për votim: kryetari konstatoi se komisioni me 6 vota për, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

#### **Rekomandim**

*Të miratohet në parim Projektligjin Nr. 06/L-132 për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit.*

### **5. Të ndryshme**

Deputeti **Danush Ademi**, shtroi çështjen e rrezikut nga qentë endacak, sidomos për fëmijët dhe pyeti kush është përgjegjës për këtë, nëse nuk është MMPH atëherë të ftohen për intervenim ata që janë, Komuna dhe AUV.

Deputetja **Besa Gaxherri**, paraqiti nevojën që pas vizitës në Obiliq, KEK dhe QAK dhe pas çdo vizite tjetër të komisionit, të nxjerren analizat dhe rekomandimet nga ajo vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

E përgatiti :

*Stafi mbështetës i Komisionit*

Kryetari i Komisionit,

-----

**Muharrem Nitaj**